

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Shtysa / *el-Himmeh* / الهَمَّة

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

“ ”

“Shikimi (i pejgamberit ﷺ) nuk u shmang e as nuk tejkaloi kufijtë.” (el-Nexhm, 17)

Shtysë (*himmeh*) është ajo që të nxitë të ndjekësh pa hile synimin. Ata që e kanë, s’do të mund ta kontrollojnë dhe as s’do të shpërqendrohen nga ajo. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është një shtysë që:

- Mbron zemrën nga poshtërsia e kërkimit të së përkohshmes
- Nxit zemrën të aspirojë të përjetshmen
- Pastron zemrën nga njolla e zvarritjes

Niveli i dytë është një shtysë që të shkakton neveri ndaj:

- Preokupimit me të meta¹
- Konsumimit nga veprat²
- Dhe mbështetjes në shpresë³

¹ Të metat këtu nënkuptojnë preokupimin me shpërblimin e veprave dhe ndikimin e tyre të menjëhershëm, siç është ndryshimi i gjendjeve shpirtërore (*ahwaal*) i cili të parandalon nga devocioni i plotë.

² Kur zemrat nuk udhëtojnë me trupat dhe veprat e së brendshmes lihen pas dore në favor të veprave të jashtme.

³ Njeriu s’bën të ketë shpresë ose besim të tepërt se do të shpëtojë. Kjo mbjell farën e arrogancës dhe të vetëmashtimit.

Niveli i tretë është një shtysë që:

- Tejkalon gjendjet dhe ndërveprimet⁴
- Dënon shpërblimet dhe gradimet⁵
- Dhe ndjek esencën (hyjnore) përtej cilësive⁶

⁴ Kur *himmeh* (shtysa) e tëra përqendrohet në një përfundim, nuk do ta lërë pa e arritur e as nuk do të shikojë në tjetër gjë veç tij.

⁵ Ndonëse gjithmonë duhet të aspirojmë shpërblimin e Allahut, kërkimi ynë i kënaqësisë së Tij gjithmonë duhet të errësojë çfarëdo kërkimi tjetër. Atyre që fitojnë kënaqësinë e Tij, s'do t'u mungojë gjë.

⁶ Përthithja nga (vetëm) një ose nga disa prej cilësive dhe veprimeve hyjnore mund të pengojë personin që të lidhet me esencën hyjnore. Reflektimi për të gjitha cilësitë është mënyra jonë për të reflektuar dhe për t'u bashkuar (shoqëruar) me esencën hyjnore.